



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
Sektori Zhvillimit Rural

Nr. 1972 prot:

Puke, me 26.10.2020

PROJEKT - VENDIM

Per miratimin per heqje nga fondi pyjor publik te siperfaqes 0.0970 ha qe do te perdoret per ndertimin e” Hec SH&SH- BICAJ” Bashkia Puke

Keshilli I Bashkise Puke ne mbledhjen e radhes te dates _____ ne zbatim te nenit 8 pika 2, neni 9, pika 1, 2, germa 'a', neni 54, germa 'c', neni 55 pika 4 te ligjit nr .139/2015, date 17.12.2015 “Per veteqeverisjen Vendore” I ndryshuar Ligji nr 48/2016” Per disa ndryshime dhe shitesa ne ligjin nr. 9385 ,date 04.05.2005” Per pyjet dhe sherbimin pyjore “I ndryshuar: ne baze te VKM nr 591 date 9.10.2018 Per disa ndryshime ne vendimin nr 1353 date 10.10.2008 “ Per percaktimin e rregullave per paraqitjen e kerkeses, mbajtjes dhe paraqitjes se dokumentacionit teknik, si dhe te kriterëve e te procedurave te zvogelimit te siperfaqes e te vellimit te fondit pyjor Pika “ç) V.K.M Nr 433, date 08.06.2016” Per transferimin sipas listes se inventarit te pyjeve dhe kullotave publike, aktualisht ne administrimin e Ministrise se Mjedisit dhe ish komunave/Bashkive ne pronesi te Bashkive, Udhezimin te Ministrise se Mjedisit nr 01 date 09.06.2016” Per rregullat ,procedurat e kerkimit ,te shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhenje ne perdorim te fondit pyjor public nga ana strukture pergjegjese per pyje :Me propozim te kryetarit Bashkise: Keshilli I Bashkise pas shqyrtimit

V E N D O S I

1. Miratimin e kerkeses per heqjen nga fondi pyjor te siperfaqes prej 0.0970 ha nga ana e Ministrise e Turizmit dhe Mjedisit
2. Siperfaqet qe do te hiqen nga fondi pyjor jane percaktuar ne raportin mbi studimin tekniko- ekonomik per dhenje ne perdorim/heqje nga fondi pyjore per ndertimin “Hec SH&SH-BICAJ”
Parcela nr 10/c siperfaqja qe do te hiqet 0.0378 ha. Pc nr 40/d siperfaqja qe do te hiqet 0.0378 ha Pc nr 8/b siperfaqja qe do te hiqet 0.0214 ha
3. Per vijimin e procedurave te heqjes nga fondi pyjor te zbatohet V.K.M nr 591 date 09.10.2018
Pika “ç) Miratimin e shkrim per vazhdimin e procedurave te heqjes nga fondi pyjor me vendim te keshillit Bashkiak, brenda territorit administrative te te cilit eshte siperfaqja pyjore e cila do ti nenshtrohet procedurave te heqjes nga fondi pyjor.”

- 4 .Per vashdimin e procedurave sipas percaktimeve te Udhezimit nr 2/2016 te Ministrise e Turizmit dhe Mjedisit,ngarkohet seksioni I pyjeve dhe kullotave ne Bashkine Puke zyra kadastres pyjore
5. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari Bashkise dhe Sektori I zhvillimit rural ,Seksioni pyjeve dhe kullotave
6. Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 pika 6, e ligjit nr 139/2015 “Per Veteqeverisjen Vendore”

HARTUESI

Ing Astrit Hyseni

JURISTI

Marte Pllumi

KRYETARI

Gjon Gjonaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
Sektori I Pyjeve dhe Kullotave

Nr. 199/prot

Pukë, më 26.10.2019

RELACION

PER MIRATIMIN ME SHKRIM PER VIJIMIN E PROCEDURAVE TE HEQJES NGA FONDI PYJOR PUBLIK TE NJE SIPERFAQE PREJ 0.0970 HA NGA ANA MINISTRISE TURIZMIT DHE MJEDISIT PER NDERTIMIN E "HEC SH&SH -BICAJ NGA SHOQERIA "MERLA-SHQIPRIK" sh.p.k

DREJTUAR :Keshillit Bashkiak Puke

Te nderuar keshilltare

Administrimi I fondit pyjore kullosore ne Bashkine Puke eshte nje nga funksionet I percaktuar ne nenin 27 te ligjit nr 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" ku ne piken 5 te ketij neni percaktohen funksionet e Bashkive ne fushen e Bujqesise zhvillimit rural pyjeve dhe kullotave publike ,natyres dhe biodiversitetit .Bashkite jane pergjegjese per kryerjen e ketyre funksioneve:pika 5 administrimi I fondit pyjore dhe kullosor eshte ligji nr 9693/2017 "per "fondin kullosor I ndryshuar " si dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij ,ne zbatim te neneve 15 dhe 17 te ketij ligji ka dale udhezimi I Ministrise Mjedisit nr 01 date 09.06.2016"Per caktimin e kriterëve per dhenje/heqje ne perdorim te fondit pyjore

Bazuar ne udhezimin e mesiperm dhe ne kerkesen e bere nga ana shoqerise "MERLA-SHQIPRIK"sh.p.k drejtuar Bashkise Puke nr prot 27/7 date 27.07.2020 pas marrjes se Miratimit Paraprak NR 11648/8 DATE 09.01.2019 per vashdimin e procedures per ndertimin e burimit rigjenerues te energjise te hidrocentralit "SH&SH-BICAJ" ne perroin e sharrit dhe perroit te zi dege e perroit Bicaj Bashkia Puke Qarku Shkoder me nje afat vleshmerie 24 muaj. I eshte drejtuar Bashkise Puke me shkresen nr prot 27/7 date 27.07.2020 ku kerkohet pergatitje e raportit tekniko-ekonomik te vleresimit financiar per ndertimin e hec SH&SH ne perroin Bicaj. Pas marrjes se kerkese nga ana Bashkise Puke eshte ngritur grupi I punes perbere nga dy injjineret pyjeve dhe eshte shkuar ne terren dhe eshte percaktuar qarte gjurma ne te cilen do te

kaloj hec SH&SH ne perroin Bicaj ne bashkine Puke dhe eshte hartuar raporti tekniko-ekonomik I vleresimit financiar ku dhe jane percaktuar siperfaqet pyjore qe do te jepen ne perdorim dhe siperfaqet qe do te hiqen nga fondi pyjor kullisor dhe volume I materialit drusore qe do te demtohet nga punimet .

Duke u bazuar ne V.K.M nr 591 date 09.10.2018 per disa ndryshime per vendimin nr 1353 date 10.10.2008 te keshillit te ministrave “Per percaktimin e rregullave per paraqitjen e kerkeses mbajtjes dhe plotesimit e dekontacionit teknik,si dhe te kritereve e procedurave te zvogelimit te siperfaqes e te vellimit te fondit pyjore” te ndryshuar pika ç kerkohet miratimi me shkrim per vashtimin e procedurave te heqjes nga fondi pyjor me vendim te keshillit Bashkiak Brenda territorit administrative te cilit eshte siperfaqja pyjore e cila do ti nenshtrohet procedurave te heqjes nga fondi pyjor nga ana Ministries Turizmit dhe Mjedisit

Ne menyre te permbledhur per heqjen nga fondi pyjore jane keto siperfaqe pyjore ne keto ekonomi pyjore ne territorin e Bashkise Puke

- Ekonomia Pyjore Kryesi Bicaj parcela nr 10/c siperfaqja qe do te hiqet nga fondi pyjore eshte 0.0378 ku do te ndertohet vepra marrjes nr 1
- Ekonomia Pyjore Kryesi Bicaj parcela nr 40/d siperfaqja qe do te hiqet nga fondi pyjore eshte 0.0378 ku do te ndertohet vepra marrjes nr 2
- Ekonomia Pyjore Kryesi Bicaj parcela nr 8/b siperfaqja qe do te hiqet nga fondi pyjore eshte 0.0214 ku do te ndertohet godina e “hec SH&SH-BICAJ”

Duke ju falenderuar ju ftojme ne miratimin e project vendimit per vijimin procedurave nga ana Ministrise Turizmit dhe Mjedisit ku kerkohet miratimi me shkrim nga ana keshillit Bashkiak per vijimin e procedures se heqjes nga fondi pyjor ne baze baze te V.K.M 591 date 09.10.2018

P/ Sektorit Zhvillimit Rural

Astrit Hyseni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

DREJTORIA E PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT NË FUSHËN E
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

Nr. 11648/P prot.

Tiranë, më 09.01.19

Lënda: Mbi dhënien e miratimit paraprak për vazhdimin e procedurave, HEC-it “Sh&Sh Bicaç”.

SHOQËRISË “MERLA SHQIPRIK” SH.P.K.
Tiranë, Njësia Nr.6, Zona 8240, Struktura 4/488;

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 49 të Ligjit nr. 43/2015 datë 30.04.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, të Vendimin nr. 822 datë 07.10.2015 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni”, të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, si dhe:

referuar Raportit të Vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Aplikimit “Për miratimin e aplikimit të aplikuesit “Merla Shqiprik” Sh.p.k., Për projektin e propozuar, për ndërtimin e objektit, hidrocentralit “Sh&Sh Bicaç” me kapacitet prodhues 531 kW, në përroin Bicaç, Bashkia Pukë, Qarku Shkodër, bashkëlidhur gjeni Miratimin Paraprak Nr. 11648/P datë 09.01.19 “Për vazhdim procedure për ndërtimin e burimit të ri gjenerues të energjisë, hidrocentralit “Sh&Sh Bicaç”, me afat të vlefshmërisë 24 muaj dhe të drejtë ekskluzive, për të bërë matje ose studime të tjera, lidhur me investimet për ndërtimin e këtij hidrocentrali.

Për sa më sipër, shoqëria “Merla Shqiprik” sh.p.k., në rast të mos pajisjes me lejet/licencat/autorizimet e organeve përkatëse të përcaktuara në nenin 24 të VKM-së së sipërcituar, për vazhdimin e mëtejshëm të procedurave me qëllim marrjen e miratimit përfundimtar të hidrocentralit në fjalë, Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në nenin 29 të VKM-së në fjalë, rezervon të drejtën për heqjen e miratimit të dhënë për ndërtimin e objektit, hidrocentralit “Sh&Sh Bicaç”.

Ju faleminderit për bashkëpunimin.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Gentian Këri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
Sektori Zhvillimit Rural

Nr/393/prot

Pukë, më 29.09.2020

RAPORT

**MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM/HEQJE
NGA FONDI PYJOR DHE KULLOSOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI
PUBLIKETË BASHKISË PUKE SUBJEKTI "MERLA-SHQIPRIK" Sh.p.k
PER NDERTIMIN E "HEC SH&SH- BICAJ"**

Bazuar në kerkesen e shoqerise "MERLA-SHQIPRIK " Sh.p.k." NR 27/7 Prot Date 27.07..2020 PER NDERTIMIN E "HEC SH&SH- BICAJ" dhe Urdhërin të kryetarit të bashkisë për vlerësimin tekniko-ekonomik dhe financiar të sipërfaqes pyjore/kullosore object per marrje ne perdorim dhe heqje nga fondi pyjor per ndertimin "HEC SH&SH- BICAJ" " grupi I punës I përbërë nga ing Astrit Hyseni , ing Edmond Prendi pasi studioi kërkesën e SHOQERISE "MERLA-SHQIPRIK " Sh.p.k PER NDERTIMIN E "HEC SH&SH- BICAJ" dhe realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore object I ndertimit te ""HEC SH&SH- BICAJ"" Mbështetur ne MIRATIMIN PARAPRAK nr 11648/8 date 09.01.2019 Per vazhdimin e procedures Per ndertimin burimit te ri gjenerues te energjise te hidrocentralit " SH&SH- BICAJ" nga ana e Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise në të dhënat e rregjistrit kadastral pyjor/kullosor rezulton që sipërfaqja e kërkuar shtrihet ngastrat/nëngastra 10/c,25/b,40/d,9/b,41/a,8/b,41/b,42/b, dhe bëjnë pjesë në ekonomine pyjore/kullosor "Kryesi Bicaj" dhe janë në pronësi/administrim të te Bashkise Puke ne baze te V.K.M. nr 433 date 08.06.2016 Përshkrimi parcelar I sipërfaqes object studimi dhe kategoria e përdorimit të saj,pasqyrohen në tabelën 1 dhe 2 të këtij raporti. Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: ka ndryshime me te dhenat e regjistrit katestral Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga Shoqerise "MERLA-SHQIPRIK " Sh.p.k PER NDERTIMIN E "HEC SH&SH- BICAJ"

, ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit dhe treguesit kryesorë të grumbujve,nga kjo siperfaqe 0.0378 ha do te hiqet nga fondi pyjor pasi do te ndertohet vepra e marrjes 1 +dekantues + Bazen e "HEC SH&SH- BICAJ" ne parcelen nr

10/c te ekonomise pyjore Kryesi Bicaj. Ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit dhe treguesit kryesorë të grumbujve, nga kjo sipërfaqe 0.0378 ha do të hiqet nga fondi pyjor pasi do të ndertohet vepra e marrjes 2 + dekantues + Bazen e “HEC SH&SH- BICAJ ne parcelen nr 40/d te ekonomise pyjore Kryesi Bicaj . ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit dhe treguesit kryesorë të grumbujve, nga kjo sipërfaqe 0.0214 ha do të hiqet nga fondi pyjor pasi do të ndertohet godina e “HEC SH&SH- BICAJ ne parcelen nr 8/b te ekonomise pyjore Kryesi Bicaj Ndersa nuk ndryshojne kategorin e perdorimit dhe rikthehen ne gjendjen e mepershme me nje gjatesi 2.51 km tubacion kanal plus trase e re qe do te kthehet ne gjendje eksistuese qe perfshihen ne parcelat e meposhme 10/c,25/b,40/d,9/b,41/a,8/b,41/b,42/b, bëjnë pjesë në ekonomin pyjore/kullosor “Kryesi Bicaj” dhe janë në pronësi/administrim të Bashkise Puke ne baze te V.K.M. nr 433 date 08.06.2016. Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor public janë të mbështetur në V.K.M-ve nr 1353, datë 10.10.2008, të ndryshuar “Përrregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, Pas miratimit të raportit tekniko- ekonomik dhe akteve të tjera normative si mësipër, “MERLA-SHQIPRIK ” Sh.p.k PER NDERTIMIN E “HEC SH&SH- BICAJ” kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur, vetëm pas lidhjes së kontratës me bashkinë Puke dhe likuidimit të tarifës prej 810.514 lekë. Ne numrin llogarise Bashkia Puke. Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-ve nr. 391, datë 21.06.2006 “Përpërcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar me VKM-venë 1064, date 22.12.2010 “Për disa ndryshime në vendimin numër 391, date 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Përpërcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit. Shuma në lek/vit konsiston në:

1 . Vlera e përdorimit për sipërfaqen e dhene hiqen/jepen perdorim

$$\text{Cungishte } 0.6032\text{ha} \times 192.000 \text{ lek} = 115.814 \text{ lekë}$$

3. Vlera e përdorimit tubacion kanal trase e re

$$\text{Cungishte } 2.51 \text{ km} \times 190000 = 476.900 \text{ leke}$$

4. Vlera perdorimit linjave elektrike

$$0.58\text{km} \times 160000 = 92.800 \text{ leke}$$


Vlera e bimesise pyjore, flores dhe faunes perbehet nga:

Lende Punimi $10 \text{ m}^3 \times 2500 = 25000$ leke

Drure zjarri $200 \text{ m}^3 \times 500$ leke = 100000 leke

PERPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO EKONOMIK

Ing Astrit HYSENI



Ing Edmond PRENDI



**MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE**

GJON GJONAJ

